



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 8.1.2025

Nr: 7

Ora: 13:00

**VENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË VORË, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALISTE TË  
SHQIPËRISË”, ZJ. ELISABETA VEHBI HAKA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 5868 prot., datë 04.11.2024, Këshilli i Bashkisë Vorë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Eduart Demir Troci, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Vorë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 14, zj. Elizabeta Vehbi Haka.

Me shkresën nr. 3169, prot., datë 06.11.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vorë, zj. Elizabeta Vehbi Haka, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 8.1.2025 Nr: 7  
Ora: 13:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, zj. Elizabeta Vehbi Haka”

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër TR-PS-9296\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Elisabeta Vehbi Haka, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit me shkresën nr. 3271 prot., datë 18.11.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 3272 prot., datë 18.11.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Elisabeta Vehbi Haka.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 12625/1 prot., datë 04.12.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Elisabeta Vehbi Haka, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 18322/1 prot., datë 27.11.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Elisabeta Vehbi Haka, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Elisabeta Vehbi Haka, në Këshillin e Bashkisë Vorë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë, me kandidatin nga lista shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Elisabeta Vehbi Haka.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**